



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1959, datë 24.05.2012

Për

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1910, datë 30.04.2012, Per
“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit
midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1910, datë 30.04.2012, Per
“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit
midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”,**

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Rregullore Nr. 24, datë 02. 02. 2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me VKD nr. 1774, datë 02. 02. 2012.
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1910, datë 30.4.2012, “Për Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a”
- Shkresa e AMC me nr. 2019/3Prot., datë 11.5.2012 (nr. 558/6Prot. i AKEP, datë 14.5.2012), “Përgjigje e shoqërisë AMC mbi vendimin nr. 1910, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a””;
- Shkresa e Neofone me nr. 169Prot., datë 14.5.2012 (nr. 558/7Prot., datë 16.5.2012) “Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1911, datë 30.4.2012”, si edhe
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me anë të Vendimit nr. 1910, datë 30.04.2012, Per “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- “Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.;
- Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Neofone sh.p.k. Albanian Mobile Communications sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
- Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;

2. AMC, me shkresën nr. 2019/3Prot., datë 11.5.2012, sqaron se, është njohur me vendimin e AKEP Nr. 1910, datë 30.04.2012 *“Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.*

AMC me anë të letrës me nr. 813 Prot. datë 07.02.2012 *“Njoftimi i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga data 15.02.2012”*, njofton ndryshimin e Tarifës së Interkoneksionit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare drejt rrjetit AMC. Kjo e bazuar në vendimin e AKEP nr. 1739 datë 01.02.2011 në të cilin është vendosur që kjo tarifë nuk është nën rregullim duke filluar nga data 01.02.2012. AMC ka ndjekur të njëjtën procedur me Neofone sic e ka ndjekur me të gjithë operatorët e tjerë alternativë.

Neofone me anë të shkresës nr. 128. Prot datë 08.02.2012, kërkon zhvillimin e negociatave dy palëshe në zbatim të kuadrit rregullator. AMC i është përgjigjur Neofone se është dakort për të zhvilluar takimin, takimi i cili u mbajt në ambientet e AMC më datë 10 shkurt 2012 ora 13:00.

AMC në takimin e mbajtur i shpreh Neofonit se qëndrimi i saj është konform gjith kuadrit rregullator në fuqi dhe se ajo ka ndjekur parimin e mosdiskriminit për të gjithë operatorët alternativë duke i trajtuar në të njëjtën mënyrë. Neofone nuk ishte dakort me këtë qëndrim të mbajtur nga AMC dhe nuk ishte dakort për tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare.

AMC dërgon amendamentin e marrëveshjes së interkoneksionit për këtë çështje me anë të letrës datë 08.02.2012 me nr 847. Prot . Neofone nuk ak firmosur amendamentin e marrëveshjes së interkoneksionit të paraqitur nga AMC dhe nuk ishte dakort për tarifën.

AMC u detyrua të ndërpriste trafikun ndërkombëtar nëpërmjet Neofonit. Për këtë ndërprerje AMC i ka dërguar njoftim Neofonit me anë të shkresës nr 847 Prot, datë 08.02.2012 në të cilin thuhej se *“Në munges të këtij konfirmimi, duke filluar nga data 15 shkurt 2012 subjektit tuaj nuk do ti ofrohet shërbimi i trafikut ndërkombëtar”*.

Neofone e dhe përpara datës 15 shkurt 2012 nuk dërgonte trafik ndërkombëtar në rrjetin e AMC, pra flasim përpara se të hynte në fuqi tarifa e re.

Trafiku kombëtar nuk është ndërprerë, edhe pse Neofone ka marrë autorizimin për zhvillimin e një rrjeti të telefonis fikse, trafiku i realizuar është po thuhet se zero, duke na detyruar të alkojmë burime që nuk shfrytëzohen.

AMC ka qenë gjithmonë e gatëshme për të zgjidhur problemin. Kështu më 20.04.2012, me ftesë të AKEP, palët janë thirrur në seancë paraprake. AMC u paraqiti në takim në kohën e duhur, por takimi nuk u realizua sepse pala paditëse (Neofone) nuk u paraqiti në takim.

AMC në bazë të zhvillimeve të fundit në rregullator në lidhje me vendimet, i ka dërguar tek të gjithë operatorët e interkonektuar letër për ndryshimet e bëra nga AKEP për informacionet e kërkuar ku Neofone nuk ka kthyer një përgjigje.

3. Neofone me shkresën nr. 169Prot., datë 14.5.2012, “Parashtrime përfundimtare për VKD nr. 1910, datë 30.4.2012”, bashkëngjitur se ciles ka shkresat të cilave u është referuar:

- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 128. Prot datë 08.02.2012, “Përgjigje e shkresës suaj nr. 813.prot datë 07.02.2012 “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga data 15.02.2012”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 130. Prot datë 09.02.2012, “Përgjigje e shkresës suaj nr. 835. Prot datë 08.02.2012 “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare për terminimin në rrjetin fix të AMC duke filluar nga data 16.02.2012” dhe shkresës suaj nr. 847. Prot datë 08.02.2012 “Njoftim dhe dërgim i amendimit mbi tarifën e reja të terminimit për trafikun hyrës ndërkombëtar në rrjetet fiks dhe mobile”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 136. Prot datë 20.02.2012, “Për anulimin e “Faciliteve shoqëruese” të alokuara për Neofone Sh.p.k dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve me origjinë rrjetet ndërkombëtare”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 138. Prot datë 23.02.2012, “Për mos terminimin e thirrjeve të numrave të portuara nga rrjetet e tjera mobile në rrjetin AMC me origjinë rrjetet ndërkombëtare”.
- Shkresa e Neofone sh.p.k me nr. 144. Prot datë 12.03.2012, “Për moshapjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga shërbimi me kart[ë të parapaguar (OSHKP) dhe anulimin e “Facilitetit shoqëruesë” të alkoluara për Neofone sh.p.k.”
- AMC sh.a me shkresën nr. 813. Prot datë 07.02.2012, “Njoftim i tarifës së re hyrëse ndërkombëtare duke filluar nga data 15.02.2012”.
- AMC sh.a me shkresën nr. 835. Prot datë 08.02.2012, “Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtare për terminimin në rrjetin fix të AMC duke filluar nga data 16.02.2012”.
- AMC sh.a me shkresën nr. 847. Prot datë 08.02.2012, “ Njoftimi dhe dërgimi i amendimit mbi tarifën e reja të terminimit për trafikun hyrës ndërkombëtar në rrjetet Fiks dhe Mobile”.
- Korrespondencat me email e shkëmbyer midis palëve,

Neofone shpjegon se operatori FNT AMC ka kryer në menyrë të njëpasnjëshme shkeljet si më poshtë:

- Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, nenet 42 Detyrimi për akses dhe interkoneksion, 59, Detyrimi për orientim të tarifave;

- MI e lidhur mes Neofone dhe AMC e datës 31.3.2011: aneksi 4;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 420, 663, 673, 681, 682, 685, 690, 693, 707;

Neofone sqaron se MI e lidhur me AMC përcakton procedura të detajuara për rishikimin e saj. Neofone është i bindur se nuk është plotësuar asnjë kusht i MI për ndryshimin e terminimit të thirrjeve. AMC nga momenti i hyrjes në fuqi të VKD nr, 1739, është e lire por jo e detyruar të hynte në negociata komerciale me operatorët e tjerë për të përcaktuar një cmim të ndryshëm që do të ishte caktuar me vullnet të dy palëve.

Paragrafi 24.2 i MI parashikon se Neofone duhet të ishte njoftuar 30 kalendarike para datës së propozuar për negociata.

Gjithashtu MI parashikon se AMC mund të ndryshojë tarifat e publikuara që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, por duke e njoftuar operatorin tjetër te paktën tre muaj para hyrjes në fuqi të tarifës së re, pasi ky i fundit ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në se nuk është dakord me të.

Deklarimi i AMC se ka zbatuar një praktikë të njohur dhe pranuar në tregun ndërkombëtar, atë të njoftimit të çmimit, me një afat implementimi 7 ditor, përbën në thelb pohimin se AMC ka shkëlur detyrimet e MI.

Duke interpretuar dispozitat e lartpërmendura të KC dhe MI dalim në përfundimin se në mungesë të një marrëveshjeje apo procedure tjetër administrative për ndryshimin e kushteve të kontratës ose mbarimin e saj kontrata do të vazhdojë të zbatohet me kushtet për të cilat është rënë dakord.

Cdo refuzim nga AMC për të përmbushur detyrimet ekzistuese, sic ka bërë AMC, duke mbyllur kanalet e transmetimit, i jep Neofone të drejtën për të bërë kërkimet sipas nenit 476, të KC.

Me datë 15.2.2012, AMC ka bllokuar 29 kanale të interkoneksionit, dhe aktualisht është i hapur vetëm një kanal. Sipas nenit 4.6.5, aneksi 4, i MI, kapaciteti minimal për qarqet dhe linket e interkoneksionit për çdo pikë interkoneksionit është 2Mbps (1E1). AMC ka ofruar vetëm 1/30 e kapacitetit të 1E1. Kapaciteti minimal është i detyrueshëm dhe nuk lidhet me aftësitë teknike të të operatorëve apo historikun e trafikut të tyre, sic është përpjekur të argumentojë AMC (email).

Kjo vjen edhe në kundërshtim me nenin 42, të ligjit nr, 9918, sipas të cilit OFNT detyrohen të mos anullojnë aksesin në facilitet kur e kanë dhënë atë.

Sa i takon tarifave të ofruara nga AMC për terminimin e thirrjeve : 22.56 lekë/min për thirrjet ndërkombëtare dhe 7.57 lekë/min për thirrjet kombëtare, çmimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nuk është pranuar nga Neofone, për shkak se është:

- Cmimi nuk është i orientuar drejt kostos, madje e tejkalon koston disa herë, duke krijuar një përqindje disa herë fitimi, si dhe duke krijuar një monopol të AMC;
- Diskriminon llojin e trafikut në lidhje me origjinën kombëtare/ndërkombëtare;
- Është tarifë më e lartë se kufiri maksimal i tarifave të rregulluara nga AKEP;
- Eshtë disa herë më e lartë se cmimet mesatare të zbatuara në BE;
- Është cmim abuzues, shpërdorues dhe antikonkurrues, pasi është mjaftueshëm i lartë për të nxjerrë nga tregu operatorët e tjerë.

AMC në zbatim të ligjit nr. 9918, ka detyrimin e orientimit të tarifave drejt kostos dmth. duhet të provojë se tarifat e shërbimeve e ofruara prej tij reflektojnë kostot e shfrytëzimit eficient dhe mundësojnë një normë fitimi të arsyeshme.

Neofone shpjegon se, AMC është i vetmi operator në treg që mund të ofrojë shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrejtin e AMC, prandaj tarifa e këtij shërbimi nuk ka se si t'u nënshtrohet forcave natyrale të tregut të lire.

Heqja e detyrimit të për thirrjet ndërkombëtare është bërë për të rritur normën e fitimit në tregun e komunikimeve elektronike dhe AKEP kishte parasysh normën e fitimit të të gjithë operatorëve dhe jo vetëm të AMC, në të kundërt do ishim përpara një situatë diskriminuese.

Sipas një interpretimi sistematik dhe logjik të legjislacionit, Neofone shpjegon se parimi i mosdiskriminimit kërkon që tarifa e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të jetë e njëjtë me atë të terminimit të thirrjeve kombëtare.

Sa më lart, Neofone i kërkon AKEP që bazuar në nenet 7, 8, 61, 120:

- Të urdhërojë urgjentisht hapjen e aksesit për Neofone nga AMC dhe detyrimin për zbatim të ligjit dhe mosrestriktim të kanaleve si për trafikun kombëtar dhe për atë ndërkombëtar;
- Të përcaktojë tarifën për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e AMC në përmbushje të ligjit nr. 9918;

III. AKEP pasi ka shqyrtuar pretendimet e paleve vëren dhe vlerëson se,

1. Sipas pikës 1.a) të nenit 13 të ligjit nr. 9918, ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet kundrejt autorizimit nga AKEP-i, me përjashtim të rasteve kur rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike:

- a) nuk kanë qëllime fitimi (tregtimi) dhe kur nuk janë të disponueshme për publikun.

Në zbatim të këtij kushti ligjor dhe kompetencës së parashikuar në shkronjën p) të nenit 8 të po këtij ligji, AKEP-i në Rregullore Nr. 24, datë 02.02.2012, "Për Autorizimin e Përgjithshëm" miratuar me VKD nr. 1774, datë 02.02.2012, në procedurën e aplikimit të regjistrimit të njoftimit përcakton se kur një sipërmarrës dëshiron të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, ai autorizohet nga AKEP nëpërmjet lëshimit të Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit, pasi të ketë plotësuar kushtet:

- të jetë një operator aktiv që ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike;
- të jetë pajisur nga AKEP-i me ISPC sipas rregullave të përcaktuara në Aktin Nr. 17, datë 16. 04. 2010 "Rregulla për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve".

Gjithashtu sipas nenit 13 të Rregullos nr. 24, datë 02. 02. 2012 "Për Autorizimin e Përgjithshëm", përcaktohet se: *"Të gjitha konfirmimet e njoftimit të lëshuara sipas*

rregullores Nr. 3, datë 19. 09. 2008, mbeten në fuqi dhe veprojnë deri në çastin e ndryshimit të tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore por jo më vonë se 3 muaj nga data e miratimit të saj". Kjo do të thotë që brenda këtij afati ligjor (deri më datë 08.05. 2012), të gjithë sipërmarrësit e interesuar duhet të aplikojnë dhe të pajisen me Çertifikatën e Njoftimit të Konfirmimit sipas Rregullores së re Nr. 24, datë 02.02.2012 "Për Autorizimin e Përgjithshëm". Pas këtij afati, asnjë sipërmarrës nuk është i autorizuar të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike nëse nuk është pajisur më parë nga AKEP-i me Çertifikatën e Regjistrimit të Njoftimit për ofrimin e tyre.

Sipas këtyre kushteve ligjore dhe rregullatore, ankimesi nuk mund të ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, pasi në përfundim të afatit tranzitor sipas nenit 13 të Rregullores nr. 24, datë 02.02.2012 "Për Autorizimin e Përgjithshëm" deri në datën e shqyrtimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas këtij vendimi, nuk është i autorizuar ta ofrojë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, sepse gjendet në kushtet e mosplotësimit të kushteve sipas Aktit Nr. 17, datë 16.04.2010 "Rregulla për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve".

2. Për sa i përket periudhës nga data e pranimit të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe fillimit të procedimit administrativ sipas VKD nr. 1910, datë 30.04.2012 "*Për Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a*", bazuar në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga palët duke iu referuar bazës ligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi në atë periudhë, mosmarrëveshja duhet të çmohet duke marrë në konsideratë se AKEP me VKD nr.1739 datë 20.12.2011, ka vendosur që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranziturara të jetë jashtë rregullimit duke filluar nga data 1.02.2012. Njëkohësisht AKEP me VKD nr.1883, datë 19.04.2012 ka miratuar edhe shtesat dhe ndryshimet përkatëse të RIO së AMC, ku janë materializuar vendimet e AKEP-it për këtë çështje. Në këto kushte palët për nivelin e tarifës (çmimin) për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara duhet të bien dakort midis tyre mbi bazën e negociatave në kushtet e lirisë kontraktuale për vendosjen e një çmimi në përputhje me interesat reciproke komerciale. Sipas këtij kushti sipërmarrësi AMC ka lidhur marrëveshtjet e interkoneksionit dhe me sipërmarrësit e tjerë të interesuar. Duke iu referuar fakteve të paraqitura nuk rezulton që AMC të mos ia ketë ofruar Neofon-it të njejtën tarifë që ka lidhur edhe me sipërmarrësit e tjerë për këtë shërbim. Ka qenë Neofone ajo që nuk e ka pranuar këtë tarifë të AMC, duke mos marrë në konsideratë faktin që tashmë kjo tarifë është jashtë rregullimit nga AKEP-i.

3. Pretendimet e Neofone për interkonektimin me AMC kanë lidhje me shërbimin e Neofone të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për terminim në rrjetin AMC dhe jo për shërbimin publik telefonik fiks të ofruar pajtimtarëve të rrjetit publik fiks Neofone. Neofone ka deklaruar se nuk ka pajtimtarë telefonik fiks për 2010 dhe 2011, duke ofruar vetëm tranzitim thirrjesh.

4. Nga sa faktohet më sipër, në interpretim të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 9918, duke qenë se Neofone sh.p.k., në momentin e shqyrtimit të këtij vendimi nuk është i autorizuar nga AKEP-i sipas legjislacionit dhe kuadrit rregullator në fuqi për ofrimin e shërbimit të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, për rrjedhojë nuk gjendet në rrethanat e

plotësimit të kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 9918 për vendosjen ndaj AMC të detyrimit me anë të një Urdhëri për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e terminimit në rrjetin e AMC të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara prej tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimin administrativ të filluar me Vendimin Nr. 1910, datë 30.04.2012 *“Për Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”*.
2. Të mos pranojë kërkesën e Neofone sh.p.k., për nxjerrjen e një Urdhëri për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me sipërmarrësin Albanian Mobile Communications Sh.a., për shërbimin e terminimit në rrjetin e Albanian Mobile Communications të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara prej tij.
3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE